

# MANUAL për Punën e Këshillave Kombëtarë të pakicave kombëtare në Republikën e Serbisë



Financuar  
nga Bashkimi Evropian  
dhe Këshilli i Evropës



EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Zbatohet  
nga Këshilli i Evropës



Ministria e të Drejtave të Njeriut dhe të  
Pakicave dhe Dialogut Shoqëror



**M A N U A L**

**për**

**Punën e Këshillave Kombëtarë të pakicave kombëtare**

**në Republikën e Serbisë**

*Titulli i publikimit në gjuhën shqipe: Priručnik za rad nacionalnih saveta nacionalnih manjina u Republici Srbiji*

*Ky publikim është prodhuar me ndihmën financiare të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës. Pikëpamjet e shprehura këtu janë përgjegjësi e autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet zyrtare të Bashkimit Evropian ose të Këshillit të Evropës.*

Lejohet riprodhimi i fragmenteve (deri në 500 fjalë), përveç për qëllime komerciale, me kusht që të ruhet integriteti i tekstit, që fragmenti të mos përdoret jashtë kontekstit, të mos japë informacion jo të plotë ose të mashtrorë lexuesin për natyrën, vëllimin ose përmbajtjen e tekstit. Burimi i tekstit duhet të tregohet gjithmonë si më poshtë:

"© Këshilli i Evropës, 2022".

Të gjitha kërkesat e tjera për riprodhim/përkthim të publikimit dhe tekstit të plotë duhet t'i drejtohen Drejtorisë për Komunikim, Këshillit të Evropës (F-67075 Strasbourg Cedex ose në [publicing@coe.int](mailto:publicing@coe.int)).

E gjithë korrespondenca tjetër në lidhje me këtë publikim duhet t'i adresohet: Drejtorisë për Demokraci të Këshillit të Evropës, Departamentit për Luftën kundër Gjuhës së Urrejtjes dhe për Bashkëpunim.

Email: [Horizontal.Facility@coe.int](mailto:Horizontal.Facility@coe.int)

Dizajni dhe faqosja:

Dosije Studio, Beograd

© Këshilli i Evropës, prill 2022. Të gjitha të drejtat e rezervuara.  
Licencuar sipas kushteve në Bashkimin Evropian.

## **PËRMBATJA**

HYRJE	1
1. QËLLIMI DHE SYNIMI I MANUALIT	2
2. VËREJTJE TË PËRGJITHSHME	3
3. ÇËSHTJET E STATUSIT TË KËSHILLAVE KOMBËTARE TË PAKICAVE KOMBËTARE	4
4. FINANCIMI I KËSHILLAVE KOMBËTARË	22
5. KËSHILLAT KOMBËTARË NË FUSHËN E ARSIMIT	24
5.1. Dhënia e mendimit	26
5.2. Dhënia e propozimit	36
6. KËSHILLAT KOMBËTARË NË FUSHËN E PËRDORIMIT ZYRTAR TË GJUHËS DHE SHKRIMIT	41
6.1. Vendimmarrja e pavarur	43
6.2. Dhënia e propozimit	46
7. KËSHILLAT KOMBËTARË NË FUSHËN E KULTURËS	54
7.1. Emërimi i anëtarëve të Bordit Drejtues	55
7.2. Dhënia e mendimit	56
8. KËSHILLAT KOMBËTARË NË FUSHËN E INFORMIMIT	64
9. KËSHILLAT KOMBËTARË DHE AUTORITETET E PAVARUR	72
9.1. Mbrojtësi i Qytetarëve	72
9.2. Komisioneri për Mbrojtjen e Barazisë	76

## HYRJE

Për një kohë të gjatë, Republika e Serbisë ka treguar pa mëdyshje dhe në mënyrë konkrete vendosmërinë dhe përkushtimin e saj për mbrojtjen e plotë, në kohë dhe efektive të lirive dhe të drejtave të pjesëtarëve të pakicave kombëtare që jetojnë në të.

Pjesë përbërëse e këtij angazhimi është zhvillimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i kuadrit ligjor që mundëson ruajtjen e identitetit individual dhe kolektiv të personave që u përkasin pakicave kombëtare.

Në të njëjtën kohë, ky përparim në nivelin normativ nënkupton një rritje të numrit të rregulloreve ligjore, kompleksitetin e tyre, si dhe ndërlihdjen midis tyre. Prandaj, bëhen përpjekje çdo ditë për të siguruar që përmirësimi i rregulloreve ligjore, në tërësinë e tyre dhe njëkohësisht, të shoqërohet me një përmirësim të zbatimit të tyre. Një nga këto përpjekje është edhe përpilimi i këtij Manuali. Zbatimi i tij duhet të bëjë që Këshillat Kombëtarë të ushtrojnë kompetencat publike në mënyrë njëkohësisht efikase dhe efektive.

Ato ekzistojnë dhe punojnë në një mjedis dinamik social dhe ligjor, i cili shpesh është i ndryshueshëm, ndonjëherë pavarësisht dëshirave dhe interesave të tyre, gjë që mund dhe shpeshherë ndikon në punën e tyre, pavarësisht nëse bëhet fjalë për ushtrimin e të drejtave apo përmbushjen e detyrimeve.

Prandaj, përforcimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i kapaciteteve institucionale është thelbësor për realizimin dhe mbrojtjen e ardhshme të lirive dhe të drejtave të personave që u përkasin pakicave kombëtare, si dhe zhvillimin e tyre të mëtejshëm. Në veçanti, forcimi dhe përmirësimi i kapacitetit institucional të Këshillave kombëtarë të pakicave kombëtare, të cilat duhet të luajnë një rol vendimtar në mbrojtjen dhe ushtrimin e të drejtave të anëtarëve të tyre.

## **1. QËLLIMI DHE SYNIMI I MANUALIT**

Ky Manual nuk tenton të bëhet pjesë e domosdoshme e diskutimeve akademike ose teorike. Qëllimi i tij kryesor është të bëhet një mjet i dobishëm për Këshillat Kombëtarë të pakicave kombëtare, domethënë t'u ofrojë përfaqësuesve dhe anëtarëve të tyre, në formë ndihme dhe mbështetjeje, udhëzime dhe këshilla praktike që nuk kanë ekzistuar, ose ekzistojnë por nuk janë përpunuar në mënyrë unike dhe të gjithëpranuar.

Qëllimi kryesor i Manualit është t'u mundësojë përdoruesve të gjejnë në një vend shembuj praktikë të akteve që Këshillat Kombëtarë të pakicave kombëtare, në përputhje me rregulloret, mund të miratojnë, si dhe këshilla mbi hapat dhe aktivitetet që duhen ndërmarrë në mënyrë që disa nga kompetencat publike të cilat u janë besuar atyre të kryhen në kohën e duhur, në mënyrë të plotë dhe efektive. Me ndihmën e Manualit, Këshillat Kombëtarë të pakicave kombëtare, me shtime dhe ndryshime minimale në aktet e ofruara me të dhëna specifike, mund të ushtrojnë më me lehtësi dhe efikasitet kompetencat publike që u janë besuar.

Qëllimi i Manualit është që të gjithë ose një shumicë e madhe e Këshillave Kombëtarë të interesuar të pakicave kombëtare, përmes zbatimit të tyre, të arrijë një shkallë sa më të lartë të mundshme të efikasitetit në ushtrimin e kompetencave publike, uniformitetin në adresimin e organeve kompetente shtetërore dhe veprimin në përputhje me praktikën më të mira. Kjo në mënyrë që të arrihen standardet më të larta ndërkombëtare.

## **2. VËREJTJE TË PËRGJITHSHME**

**Ministria e të Drejtave të Njeriut e të Pakicave dhe Dialogut Shoqëror** duke kryer detyrat brenda kompetencës së saj, ka vërejtur se, pas miratimit të ndryshimeve dhe plotësimeve të ligjeve ekzistuese për pakicat dhe zgjedhjet e kryera për Këshillat Kombëtarë të pakicave kombëtare në vitin 2018, ka nevojë që disa nga çështjet më të rëndësishme që lidhen me punën e Këshillave Kombëtarë të pakicave kombëtare të përpunohen më saktësisht, të theksohen dhe të paraqiten në mënyrë praktike.

Në kuadër të projektit të Këshillit të Evropës dhe Bashkimit Evropian - Promovimi i Diversitetit dhe Barazisë - është përgatitur edhe ky manual sipas fushave në të cilat Këshillat Kombëtarë ushtrojnë kompetencat e tyre me modelet e akteve.



### 3. ÇËSHTJET E STATUSIT TË KËSHILLAVE KOMBËTARE TË PAKICAVE KOMBËTARE

Kur bëhet fjalë për natyrën ligjore të këshillave kombëtare të pakicave kombëtare, termat "*organ i vetëqeverisjes kulturore*" dhe "*forma e autonomisë kulturore*" janë të përfaqësuar në mënyrë të barabartë në përdorimin publik.

#### **Ligji për Këshillat Kombëtarë të Pakicave Kombëtare**

("Gazeta Zyrtare e RS", nr. 72/2009, 20/2014 - vendimi i GJK, 55/2014 dhe 47/2018)

Neni 1a

"Këshilli Kombëtar është **organizata** të cilës i besohen me ligj **disa kompetenca të caktuara publike...**"

Kompetencat publike të besuara Këshillave Kombëtarë të pakicave kombëtare përcaktohen në mënyrë të dyfishtë:

- sipas funksionit/përmbajtjes

#### **Ligji për Këshillat Kombëtarë të Pakicave Kombëtare**

("Gazeta Zyrtare e RS", nr. 72/2009, 20/2014 - vendimi i GJK, 55/2014 dhe 47/2018)

"Neni 1a

..... të marrë pjesë në vendimmarrjen ose të vendosë në mënyrë të pavarur për ....."

- sipas fushave

#### **Ligji për Këshillat Kombëtarë të Pakicave Kombëtare**

("Gazeta Zyrtare e RS", nr. 72/2009, 20/2014 - vendimi i GJK, 55/2014 dhe 47/2018)

"Neni 1a

.... për çështje të caktuara në fushën e **kulturës, arsimit, informacionit dhe përdorimit zyrtar të gjuhës dhe shkrimit** .....

- sipas synimit dhe qëllimit që dëshirohet të arrihet

### **Ligji për Këshillat Kombëtarë të Pakicave Kombëtare**

("Gazeta Zyrtare e RS", nr. 72/2009, 20/2014 - vendimi i GJK, 55/2014 dhe 47/2018)

"Neni 1a

.... me qëllim **ushtrimin e të drejtave kolektive** të pakicës kombëtare **për vetëqeverisje në këto fusha.**"

Një nga detyrimet themelore të këshillave kombëtare është të sigurojnë **publikimin e punës së tyre.**

Publikimi i punës është një parakusht themelor për të arritur besimin, si të organeve shtetërore ashtu edhe të anëtarëve të pakicës kombëtare, në rezultatet, efikasitetin dhe veprimin në kohë të këshillave kombëtare gjatë ushtrimeve të kompetencave publike që u janë besuar.

### **Ligji për Këshillat Kombëtarë të Pakicave Kombëtare**

("Gazeta Zyrtare e RS", nr. 72/2009, 20/2014 - vendimi i GJK, 55/2014 dhe 47/2018)

"Neni 8a

**Puna** e Këshillit Kombëtar është **publike.**

**Të gjitha vendimet dhe aktet** e Këshillit Kombëtar **publikohen jo më vonë se 10 ditë nga dita e hyrjes në fuqi, respektivisht nga miratimi i tyre, në faqen e internetit e Këshillit Kombëtar** ..... ose **në ndonjë mënyrë tjetër të përcaktuar me statut** ....."

E HËNË E DIEL	E MARTË	E MËRKURË	E ENJTE	E PREMTE	E SHTUNË
	<b>Vendimi/akti i miratuar</b>				
					<b>X</b>

Në lidhje me përmbushjen e këtij detyrimi, është e rëndësishme të theksohet si në vijim:

**- se për përmbushjen e këtij detyrimi duhen planifikuar në kohë fondet në buxhetet e tyre;**

**- detyrimi për të publikuar dokumente të cilat, sipas akteve të përgjithshme të Këshillit, kërkojnë konfirmim, miratim ose vendim të mëvonshëm të performancës pas aktivitetit në fjalë, dhe**

**- që është e nevojshme që Këshillat, përveç publikimit të akteve, t'u japin anëtarëve qasje në dokumentacionin e krijuar në punën e Këshillit, si dhe t'u sigurojnë atyre kopje me kërkesën e tyre. Sipas të dhënave të disponueshme në faqet zyrtare të internetit të Këshillave Kombëtarë, rrallë herë ndodh që ata të përmbushin detyrimin e përshkruar nga neni i mësipërm në një mënyrë që lejon shkallën më të lartë të mundshme të publikimit - duke publikuar të gjitha vendimet dhe aktet në faqet e tyre zyrtare të internetit.**

Këshilli Kombëtar është **person juridik**, në formën e një **organizate**, e cila ka të drejta dhe detyrime ligjore. Në të njëjtën kohë, Këshillat Kombëtarë ndryshojnë dhe në bazë të Ligjit dallohen qartazi nga organizatat e tjera, veçanërisht nga ato të menduara nga numri më i madh i qytetarëve laikë, p.sh. organizatat e shoqërisë civile, sepse ato janë organizata "sui generis".

Këshilli Kombëtar fiton statusin e një personi juridik duke u regjistruar në **Regjistrin e Këshillave Kombëtare**, i cili aktualisht mbahet nga **Ministria e të Drejtave të Njeriut e të Pakicave dhe Dialogut Shoqëror**. Regjistri mbahet në mënyrë të dyfishtë:

- në formën e një libri me kopertina e lidhje të fortë dhe
- në formën e një baze elektronike të dhënash

**Të dhënat** e futura në Regjistër janë **publike**.

Të dhënat nga regjistri i mbajtur në formën elektronike janë të disponueshme për publikun në një dokument të titulluar **"Ekstrakt nga Regjistri i Këshillave Kombëtarë"**, i cili mund të gjendet në faqen zyrtare të internetit <http://mduls.gov.rs/wp-content/uploads/lzvod-iz-Registar-nacionalnih-saveta-5.3.2020.pdf>.

### Ligji për Këshillat Kombëtarë të Pakicave Kombëtare

("Gazeta Zyrtare e RS", nr. 72/2009, 20/2014 - vendimi i GJK, 55/2014 dhe 47/2018)

"Neni 3

Këshilli Kombëtar regjistrohet në Regjistër në bazë të **kërkesës** për regjistrim, të cilën Kryetari i Këshillit Kombëtar duhet ta **dorëzojë në Ministri** brenda **5 ditësh** nga dita kur në **mbledhjen e parë** të Këshillit Kombëtar është **zgjedhur kryetari** i Këshillit Kombëtar."

E HËNË E DIEL	E MARTË	E MËRKURË	E ENJTE	E PREMTE	E SHTUNË
		<b>1. Përbërja e Këshillit Kryetari i zgjedhur KK</b>			
	<b>X</b>				

**VËREJTJE:** Në përgjithësi, afatet e përcaktuara për ushtrimin e kompetencave publike janë të shkurtra dhe jo gjithmonë ka kohë të mjaftueshme për Këshillat Kombëtarë që të shqyrtojnë në detaje dhe plotësisht lëndët përkatëse dhe të marrin vendimet e duhura. Sidomos kur kemi parasysh kapacitetet dhe kushtet në të cilat punojnë Këshillat Kombëtarë. Është e nevojshme të mendohet për rregullimin e tyre në një mënyrë të re dhe ndryshe.

**Formulari i aplikimit** i përmendur në nenin e cituar është **pjesë përbërëse e Rregullores mbi mënyrën e regjistrimit dhe mbajtjen e Regjistrit të Këshillave Kombëtarë** ("Gazeta Zyrtare e RS" nr. 72/2014 dhe 61/2018). Në mënyrë që aplikimi të ketë rezultate, d.m.th. që të fitohet statusi i një personi juridik, është e nevojshme, përveç kërkesës së plotë dhe të saktë, të paraqiten **shtojcat** e duhura **dorëzimi i të cilave është i domosdoshëm**.

#### **Ligji për Këshillat Kombëtarë të Pakicave Kombëtare**

("Gazeta Zyrtare e RS", nr. 72/2009, 20/2014 - vendimi i GJK, 55/2014 dhe 47/2018)

"Neni 3

Bashkë me **aplikimin** për regjistrim dorëzohen:

- a. **procesverbali i seancës në të cilën është konstatuar përbërja e parë** e Këshillit Kombëtar,
- b. **dy kopje të Statutit** të Këshillit Kombëtar dhe
- c. **Vendimi i zgjedhjes së Kryetarit** të Këshillit Kombëtarë."

Me dispozitë të aktit nënligjor janë renditur të gjitha provat që duhet të dorëzohen bashkë me kërkesën për regjistrimin e Këshillit Kombëtar në Regjistër.

#### **Rregullore mbi mënyrën e regjistrimit dhe mbajtjes së Regjistrit të Këshillave Kombëtarë**

("Gazeta Zyrtare e RS", nr. 72/2014 dhe 61/2018)

"Neni 9

Bashkë me **aplikimin** për regjistrim dorëzohen:

- a. procesverbali nga seanca në të cilin u krijua përbërja e parë e Këshillit Kombëtar,
- b. dy kopje të Statutit të Këshillit Kombëtar,
- c. Vendimi për zgjedhjen e Kryetarit të Këshillit Kombëtar,
- d. **një fotokopje të vërtetuar të kartës së identitetit të Kryetarit të Këshillit Kombëtar dhe**
- e. **prova e pagesës së tarifës administrative të republikës."**

**VËREJTJE: Aplikimi për regjistrimin e të dhënave në Regjistrin e Këshillave Kombëtare paraqitet nga pakicat kombëtare që formojnë një këshill kombëtar për herë të parë, domethënë ata që zgjidhen për herë të parë, ndërsa të gjithë të tjerët (pas zgjedhjeve dhe më pas gjatë mandatit) paraqesin një kërkesë për regjistrimin e ndryshimeve të dhënave.**

Gjegjësisht, të gjitha të dhënat e regjistruara në Regjistër në bazë të aplikacionit mund të ndryshohen në varësi të faktit nëse ka nevojë për këtë (p.sh. statuti i Këshillit Kombëtar, kryetari, selia dhe të dhëna të tjera). **E drejta** e Këshillit Kombëtar për të ndryshuar të dhënat e tij korrespondon me **detyrimin e tij për të raportuar ndryshimin** e këtyre të dhënave për **regjistrimin e tyre në Regjistrin e Këshillave Kombëtare.**

**Ligji për Këshillat Kombëtarë të Pakicave Kombëtare**

("Gazeta Zyrtare e RS", nr. 72/2009, 20/2014 - vendimi i GJK, 55/2014 dhe 47/2018)

"Neni 4a

Këshilli Kombëtar **duhet** të paraqesë **kërkesën për regjistrimin e ndryshimeve të dhënave** që janë regjistruara në Regjistër brenda **dhjetë ditëve nga data e ndryshimit.**

Së bashku me kërkesën për regjistrimin e ndryshimeve të dhënave, duhet të paraqitet **dëshmi e ndryshimit**, ndërsa me kërkesën për regjistrimin e **ndryshimeve dhe plotësimeve të statutit**, dorëzohet **procesverbali i mbledhjes** në të cilën janë aprovuar ndryshimet dhe plotësimet e statutit, si dhe **dy kopje të vendimit** për ndryshimet dhe plotësimet e statutit...."

E HËNË E DIEL	E MARTË	E MËRKURË	E ENJTE	E PREMTE	E SHTUNË
<b>Dita e ndryshimeve të dhënave</b>					
				<b>X</b>	

Edhe në këtë rast, dispozita e aktit nënligjor parashikon të gjitha provat që duhet të paraqiten me kërkesën për regjistrimin e ndryshimeve e të dhënave në Regjistër.

**Rregullore mbi mënyrën e regjistrimit dhe mbajtjes së Regjistrit të Këshillave Kombëtarë**

("Gazeta Zyrtare e RS", nr. 72/2014 dhe 61/2018)

"Neni 11

**Së bashku me kërkesën për ndryshimin e të dhënave në Regjistër, dorëzohet:**

- a. **procesverbali i mbledhjes** në të cilën është marrë vendimi për ndryshimin e të dhënave, në kopje origjinale ose të vërtetuar,
- b. **vendimi** i ndryshimit të dhënave,
- c. **prova e** ndryshimit të dhënave dhe
- d. **prova e pagesës së tarifës administrative të republikës."**

Formulari i aplikimit për regjistrimin e të dhënave është pjesë përbërëse e Rregullores derisa, nga ana tjetër, Rregullorja nuk parashikon formën e detyrueshme **të Formularit të Aplikimit për ndryshimin e të dhënave**. Kjo është arsyeja pse Manuali propozon një model të Formularit të Aplikimit për regjistrimin e ndryshimeve të dhënave në Regjistrin e Këshillave Kombëtarë.



**Modeli i Formularit të Aplikimit për regjistrimin  
e ndryshimeve të dhënave**

**MINISTRIA PËR TË DREJTAT E NJERIUT E TË PAKICAVE  
DHE DIALOGUN SHOQËROR  
Bulevar Mihajla Pupina 2  
BEOGRAD**

**A P L I K I M**

**PËR**

**REGJISTRIMIN E NDRYSHIMIT TË DHËNAVE TË KËSHILLIT  
KOMBËTARË NË REGJISTRIN E KËSHILLAVE KOMBËTARE**

1) Selia dhe adresa e Këshillit Kombëtarë të pakicës kombëtare

---

2) Kryetari i Këshillit Kombëtarë të pakicës kombëtare (emri dhe mbiemri,  
adresa e banimit dhe numri personal)

---

3) Data e miratimit të Statutit të Këshillit Kombëtar të pakicës kombëtare,  
respektivisht të ndryshimeve dhe plotësimeve të tij

---

4) Data e mbajtjes së seancës konstituive (***Shënim: pas çdo cikli zgjedhor  
në Regjistër futet data e konstituimit të përbërjes së re të Këshillit  
Kombëtar***)

---

**Njëkohësisht me nënshkrimin e këtij Aplikimi, jam informuar për  
përpunimin e të dhënave personale dhe jam dakord që të dhënat**

**nga ky Aplikim, si dhe nga shtojcat e bashkangjitura të dorëzuara me të, të përpunohen në përputhje me ligjin që përcakton përpunimin e të dhënave.**

**Shtojca<sup>1</sup>:**

- procesverbali i seancës konstitutive të Këshillit Kombëtarë,
- procesverbali i mbledhjes në të cilën është marrë vendimi për ndryshimin e të dhënave, për ndryshimin dhe/ose plotësimin e Statutit të Këshillit Kombëtar në kopje origjinale/të noterizuar,
- dy kopje të vendimit për ndryshimet dhe/ose plotësimet e Statutit/Vendimit për zgjedhjen e Kryetarit të Këshillit Kombëtar/Vendimit për ndryshimin e të dhënave/,
- prova e ndryshimit të dhënave,
- dy kopje të Statutit të ri/të ndryshuar ose të plotësuar të Këshillit Kombëtar,
- një fotokopje e vërtetuar e kartës së identitetit të Kryetarit të Këshillit Kombëtar,
- mandati i pagesës së tarifës administrative të republikës.

U përmend më herët se parakushti për realizimin në kohë, në mënyrë efikase dhe të plotë dhe mbrojtjen e të drejtave të anëtarëve të pakicës kombëtare është respektimi i parimit të "qeverisjes së mirë" në punën e Këshillave Kombëtarë. Me analizimin e të dhënave dhe dokumenteve publike në dispozicion, mund të vërehet se:

- shumica e akteve të shumicës së Këshillave Kombëtarë **nuk kanë në dispozitat e tyre deklaratat për disa çështje** që duhet të zgjidhen dhe të përshkruhen në to, dhe
- shumica e akteve të pjesës më të madhe të Këshillave Kombëtarë **nuk përmbajnë arsyeime**, dhe në rastet kur i përmbajnë, **shpjegimet e tyre nuk trajtojnë të gjitha çështjet përkatëse ose nuk japin një fakt vendimtar se pse u morën ato vendime konkrete.**

---

<sup>1</sup> Rrumbullakosni një nga opsionet e paraqitura, në varësi të llojit të të dhënave që ndryshojnë.

## Modeli i Vendimit për ndryshimin e të dhënave nr. 1a

### KËSHILLI KOMBËTAR I

### PAKICËS KOMBËTARE \_\_\_\_\_

### Republika e Serbisë

**Numri:** \_\_\_\_\_

**Data:** \_\_\_\_\_

**Vendi:** \_\_\_\_\_

Në bazë të nenit 7, paragrafit 3, dhe nenit 8, paragrafit 3. të Ligjit për Këshillat Kombëtarë të pakicave kombëtare ("Gazeta Zyrtare e RS", nr. 72/2009, 20/2014 - vendimi i GJK, 55/2014 dhe 47/2018) (në tekstin e mëtejshëm: Ligji), ndërsa në përputhje me nenin \_\_\_\_ të Statutit të Këshillit Kombëtar të pakicës kombëtare \_\_\_\_\_ (Numër: \_\_\_\_\_ të datës \_\_\_\_\_ 20\_\_\_\_\_) (në tekstin e mëtejshëm: Statuti), dhe me nenin \_\_\_\_ të Rregullores për Punën e Këshillit Kombëtar të pakicës kombëtare (Numër: \_\_\_\_\_ të datës \_\_\_\_\_ në vitin 20\_\_\_\_\_) (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja)<sup>2</sup>, Këshilli Kombëtar i pakicës kombëtare \_\_\_\_\_ (në tekstin e mëtejshëm: Këshilli), në mbledhjen e mbajtur më \_\_\_\_\_ 20 \_\_\_\_\_, ka marrë këtë

## VENDIM

### I

Kryetar i Këshillit është zgjedhur \_\_\_\_\_ (emri dhe mbiemri), \_\_\_\_\_, nga \_\_\_\_\_ (emri i vendit/komunës/zytetit), rruga \_\_\_\_\_, nr. personal \_\_\_\_\_ nr. i ID-së, \_\_\_\_\_, anëtar i Këshillit.

<sup>2</sup> Zgjidhni të gjitha ose disa nga opsionet e ofruara, në varësi të organizimit të brendshëm dhe mënyrës së punës dhe vendimmarrjes së Këshillit Kombëtar të pakicës kombëtare.

## II

Mandati i Kryetarit mund të mbarojë me përfundimin e mandatit të Këshillit, me zgjedhjen e Kryetarit të ri, si dhe me shfaqjen e arsyeve të tjera të përcaktuara me Ligj dhe Statut.

## III

Kryetari i zgjedhur ka të gjitha të drejtat dhe detyrimet në përputhje me Ligjin dhe Statutin.

## IV

Kryetari i zgjedhur është i detyruar të marrë detyrën menjëherë pas miratimit të Vendimit përfundimtar për regjistrimin e ndryshimit të dhënave në Regjistrin e Këshillave Kombëtarë.

## IV

\_\_\_\_\_ (emri dhe mbiemri), \_\_\_\_\_, nga \_\_\_\_\_ (emri i vendit/komunës/qytetit), rruga \_\_\_\_\_, nr. personal \_\_\_\_\_ nr. i ID-së, \_\_\_\_\_, Kryetarit të deritanishëm Këshillit. i ndërpriten të gjitha të drejtat dhe detyrimet në ditën e miratimit të Vendimit përfundimtar për regjistrimin e ndryshimit të dhënave në Regjistrin e Këshillave Kombëtarë.

## V

Vendimi, bashkë me dokumentacionin e nevojshëm, t'i paraqitet **Ministrisë së të Drejtave të Njeriut e të Pakicave dhe Dialogut Shoqëror** për të regjistruar ndryshimin e të dhënave në Regjistrin e Këshillave Kombëtarë.

## VI

Vendimi të publikohet në tabelën e njoftimeve dhe në faqen zyrtare të internetit të Këshillit.

## **Arsyetimi**

Në përputhje me nenin \_\_\_\_\_ të Statutit dhe nenin \_\_\_\_\_ të Rregullores së Këshillit, Zëvendëskryetari/Nënkryetari/\_\_\_\_\_ (me shkronja) ( ) (me numër) nga anëtarët e Këshillit<sup>3</sup> propozuan caktimin e seancës dhe zgjedhjen e Kryetarit të ri të Këshillit.

Në bazë të dispozitës së nenit \_\_\_\_\_ të Statutit, propozimin me shkrim për zgjedhjen e Kryetarit të ri të Këshillit Kombëtar u paraqit dhe u nënshkrua nga \_\_\_\_\_<sup>4</sup>anëtarë të Këshillit.

Në mbledhjen e Këshillit, të mbajtur më \_\_\_\_\_, morën pjesë \_\_\_\_\_ (me shkronja) ( ) (me numër) prej \_\_\_\_\_ (numri total) anëtarët e Këshillit, të cilët në përputhje me nenin 7, paragrafi 3 dhe nenin 8, paragrafi 3. të Ligjit votuan për kandidatin e propozuar për Kryetarin e ri të Këshillit.

Në fillim të seancës, përfaqësuesi i propozuesit të autorizuar tha me gojë arsytet për të cilat u kërkua të caktohej seanca dhe shpjegoi propozimin për zgjedhjen e Kryetarit të ri të Këshillit.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar dhe diskutimit, duke marrë parasysh arsytet dhe pikëpamjet e deklaruara, të pranishmit vijuan me votimin.

---

<sup>3</sup> Zgjidhni një nga opsionet e ofruara në varësi të mënyrës se si Këshilli Kombëtar ka përshkruar në Statut/Rregulloren e Punës cilët janë personat e autorizuar për të caktuar seancën e Këshillit Kombëtar.

<sup>4</sup> Të plotësohet me numrin e anëtarëve të Këshillit të cilët, në përputhje me dispozitat e Statutit, janë të autorizuar të paraqesin propozimin për zgjedhjen e Kryetarit të Këshillit Kombëtar.

Për kandidatin \_\_\_\_\_ (emri dhe mbiemri),  
\_\_\_\_\_, nga \_\_\_\_\_ (emri i  
vendit/komunës/qytetit), rruga \_\_\_\_\_, nr. personal  
\_\_\_\_\_ nr. i ID-së, \_\_\_\_\_,  
anëtar të Këshillit, kanë votuar \_\_\_\_\_ (me shkronja) ( ) (me numër)  
anëtarë të Këshillit nga numri total i të pranishmëve. Kundër kandidatit të  
propozuar kanë votuar \_\_\_\_\_ (me shkronja) ( ) (me numër)  
anëtarë të Këshillit nga numri total i të pranishmëve. Nuk pati abstenime  
të anëtarëve të Këshillit.

Në përputhje me këtë, dhe bazuar në dispozitën e nenit 7, paragrafi 3,  
dhe nenit 8, paragrafi 3 të Ligjit, sipas nenit \_\_\_ të Statutit dhe nenit  
\_\_\_\_\_ të Rregullores së Këshillit, u mor vendimi nga dispozitivi.

Vendimi bashkë me dokumentacionin e nevojshëm, t'i paraqitet  
**Ministrisë së të Drejtave të Njeriut e të Pakicave dhe Dialogut  
Shoqëror** për të regjistruar ndryshimin e të dhënave në Regjistrin e  
Këshillave Kombëtarë dhe për ta publikuar në tabelën e njoftimeve, si  
dhe në faqen zyrtare të Këshillit.

Numri: \_\_\_\_\_

Data: \_\_\_\_\_

Vendi: \_\_\_\_\_

KRYETARI I KËSHILLIT KOMBËTAR/KRYESUESI I MBLEDHJES<sup>5</sup>

\_\_\_\_\_ (emri dhe mbiemri), anëtar i

Këshillit

nënsh.

---

<sup>5</sup> Zgjidhni një nga opsionet e ofruara, në varësi të llojit të situatës konkrete.

## Modeli i Vendimit për ndryshimin e të dhënave nr. 16

### KËSHILLI KOMBËTAR I

PAKICËS KOMBËTARE \_\_\_\_\_

Republika e Serbisë

Numri: \_\_\_\_\_

Data: \_\_\_\_\_

Vendi: \_\_\_\_\_

Në bazë të nenit 8, paragrafit 4 të Ligjit për Këshillat Kombëtarë të pakicave kombëtare ("Gazeta Zyrtare e RS", nr. 72/2009, 20/2014 - vendimi i GJK, 55/2014 dhe 47/2018) (në tekstin e mëtejshëm: Ligji), ndërsa në përputhje me nenin \_\_\_\_ të Statutit të Këshillit Kombëtar të pakicës kombëtare \_\_\_\_\_ (Numër: \_\_\_\_\_ të datës \_\_\_\_\_ 20\_\_\_\_\_) (në tekstin e mëtejshëm: Statuti), dhe me nenin \_\_\_\_ të Rregullores për Punën e Këshillit Kombëtar të pakicës kombëtare (Numër: \_\_\_\_\_ të datës \_\_\_\_\_ në vitin 20\_\_\_\_\_) (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja)<sup>6</sup>, Këshilli Kombëtar i pakicës kombëtare \_\_\_\_\_ (në tekstin e mëtejshëm: Këshilli), në mbledhjen e mbajtur më \_\_\_\_\_ 20 \_\_\_\_\_, ka marrë këtë

### VENDIM

#### I

Kryetari i Këshillit është zgjedhur \_\_\_\_\_ (emri dhe mbiemri), \_\_\_\_\_, nga \_\_\_\_\_ (emri i vendit/komunës/qytetit), rruga \_\_\_\_\_, nr. personal \_\_\_\_\_ nr. i ID-së, \_\_\_\_\_, hiqet nga detyra.

<sup>6</sup> Zgjidhni të gjitha ose disa nga opsionet e ofruara, në varësi të organizimit të brendshëm dhe mënyrës së punës dhe vendimmarrjes së Këshillit Kombëtar të pakicës kombëtare.

## II

Deri në zgjedhjen e kryetarit të ri, funksioni i Kryetarit të Këshillit do kryhet nga zëvendëskryetari//nënkryetari i Këshillit<sup>7</sup> \_\_\_\_\_ (emri dhe mbiemri), \_\_\_\_\_ nga \_\_\_\_\_ (emri i vendit/komunës/qytetit), rruga \_\_\_\_\_, nr. personal \_\_\_\_\_ nr. i ID-së, \_\_\_\_\_.

## III

Ky Vendim, bashkë me dokumentacionin e nevojshëm, t'i paraqitet **Ministrisë së të Drejtave të Njeriut e të Pakicave dhe Dialogut Shoqëror** për të regjistruar ndryshimin e të dhënave në Regjistrin e Këshillave Kombëtarë.

## IV

Vendimi të publikohet në tabelën e njoftimeve dhe në faqen zyrtare të internetit të Këshillit.

### ***Arsyetimi***<sup>8</sup>

---

<sup>7</sup> Zgjidhni një nga opsionet e ofruara në varësi të faktit se si Këshilli Kombëtar ka përshkruar në Statut/Rregulloren e Punës cilët janë personat e autorizuar për të përfaqësuar Këshillin kur kryetari i mëparshëm është larguar nga detyra.

<sup>8</sup> Në përputhje me parimin e qeverisjes së mirë, çdo akt ligjor që vendos për të drejtat dhe detyrimet, si dhe ai i miratuar me ushtrimin e autoritetit publik, duhet të ketë një arsyetim, pavarësisht nëse është një vendim pozitiv apo negativ. Sidomos nëse procesverbalin nga seanca në të cilën është miratuar nuk është shtojcë e domosdoshme e tij. Arsyetimi duhet të përmbajë, dhe të bëjë të disponueshme për publikun, faktet vendimtare pse dhe në çfarë mënyre është miratuar akti juridik përkatës, si p.sh. në Modelin e Vendimit për ndryshimin e të dhënave nr. 1a.



## Modeli i Vendimit për ndryshimin e të dhënave nr. 2

### KËSHILLI KOMBËTAR I

### PAKICËS KOMBËTARE \_\_\_\_\_

Republika e Serbisë

Numri: \_\_\_\_\_

Data: \_\_\_\_\_

Vendi: \_\_\_\_\_

Në bazë të nenit 6 dhe nenit 10, paragrafit 1, pikës 1 të Ligjit për Këshillat Kombëtarë të pakicave kombëtare ("Gazeta Zyrtare e RS", nr. 72/2009, 20/2014 - vendimi i GJK, 55/2014 dhe 47/2018) (në tekstin e mëtejshëm: Ligji), ndërsa në përputhje me nenin \_\_\_\_ të Statutit të Këshillit Kombëtar të pakicës kombëtare \_\_\_\_\_ (Numër: \_\_\_\_\_ të datës \_\_\_\_\_ 20\_\_\_\_\_) (në tekstin e mëtejshëm: Statuti), dhe me nenin \_\_\_\_ të Rregullores për Punën e Këshillit Kombëtar të pakicës kombëtare (Numër: \_\_\_\_\_ të datës \_\_\_\_\_ në vitin 20\_\_\_\_\_) (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja)<sup>9</sup>, Këshilli Kombëtar i pakicës kombëtare \_\_\_\_\_ (në tekstin e mëtejshëm: Këshilli), në mbledhjen e mbajtur më \_\_\_\_\_ 20 \_\_\_\_\_, ka marrë këtë

### VENDIM

për

**ndryshimin/plotësimin e Statutit të Këshillit Kombëtar të pakicës kombëtare \_\_\_\_\_ në lidhje me adresën dhe selinë**

---

<sup>9</sup> Zgjidhni të gjitha ose disa nga opsionet e ofruara, në varësi të organizimit të brendshëm dhe mënyrës së punës dhe vendimmarrjes së Këshillit Kombëtar të pakicës kombëtare.

## I

Në Statutin e Këshillit (Numri: \_\_\_\_\_ nga \_\_\_\_\_ 20 \_\_\_\_\_), në nenin \_\_\_\_\_ paragrafi \_\_\_\_\_, fjalët "në \_\_\_\_\_ (emri i vendit, bashkisë dhe/ose qytetit), rruga \_\_\_\_\_ nr. \_\_\_ " zëvendësohen me fjalët "në \_\_\_\_\_ (emri i vendit, bashkisë dhe/ose qytetit), rruga \_\_\_\_\_ nr. \_\_\_"

## II

Adresa e mëparshme e Këshillit nuk është më e vlefshme dhe nuk përdoret më në transaksionet juridike në ditën e miratimit të Vendimit përfundimtar për regjistrimin e ndryshimit të të dhënave në Regjistrin e Këshillave Kombëtarë.

## III

Vendimi, bashkë me dokumentacionin e nevojshëm, t'i paraqitet **Ministrisë së të Drejtave të Njeriut e të Pakicave dhe Dialogut Shoqëror** për të regjistruar ndryshimin e të dhënave në Regjistrin e Këshillave Kombëtarë.

## IV

Vendimi të publikohet në tabelën e njoftimeve dhe në faqen zyrtare të internetit të Këshillit.

### ***Arsyetimi***<sup>10</sup>

---

<sup>10</sup> Në përputhje me parimin e qeverisjes së mirë, çdo akt ligjor që vendos për të drejtat dhe detyrimet, si dhe ai i miratuar me ushtrimin e autoritetit publik, duhet të ketë një arsyetim, sidomos nëse procesverbal i seancës në të cilën është miratuar nuk është shtojcë e domosdoshme e tij. Arsyetimi duhet të përmbajë, dhe të bëjë të disponueshme për publikun, faktet vendimtare pse dhe në çfarë mënyre është miratuar akti juridik përkatës, si p.sh. në Modelin e Vendimit për ndryshimin e të dhënave nr. 1a.

#### 4. FINANCIMI I KËSHILLAVE KOMBËTARË

Një nga çështjet, sa të rëndësishme aq edhe interesante, është çështja e financimit të Këshillave Kombëtarë.

##### **Ligji për Këshillat Kombëtarë të Pakicave Kombëtare**

("Gazeta Zyrtare e RS", nr. 72/2009, 20/2014 - vendimi i GJK, 55/2014 dhe 47/2018)

"Neni 114

**Fondet për financimin e punës së Këshillave Kombëtarë sigurohen nga buxheti i Republikës së Serbisë, buxheti i krahinës autonome dhe buxheti i njësisë së vetëqeverisjes lokale, donacionet dhe të ardhurat e tjera."**

Fondet e siguruar në buxhetin e Republikës së Serbisë shpërndahen në mënyrë që:

- **shpërndan 30% në shuma të barabarta për të gjitha këshillat e regjistruar kombëtarë** në Republikën e Serbisë dhe
- pjesa tjetër e fondeve (**70%**) **në raport proporcional me numrin e anëtarëve të një pakice të caktuar kombëtare të përfaqësuar nga Këshilli Kombëtar sipas rezultateve të censusit të fundit të popullsisë, si dhe numrit të përgjithshëm të institucioneve, fondacioneve dhe kompanive të themeluara, ose të bashkëthemeluara nga Këshilli Kombëtar bashkëthemelues i Këshillit Kombëtar ose të drejtat e themelimit të jenë transferuar pjesërisht ose plotësisht në Këshillin Kombëtar.**

Në kuadër të kësaj çështje, fondet për financimin e punës së Këshillave Kombëtarë të cilat sigurohen nga buxheti i njësisë së vetëqeverisjes lokale meritojnë një vëmendje të veçantë.

## **Ligji për Këshillat Kombëtarë të Pakicave Kombëtare**

("Gazeta Zyrtare e RS", nr. 72/2009, 20/2014 - vendimi i GJK, 55/2014 dhe 47/2018)

"Neni 114

Fondet e parashikuara në buxhetin e njësisë së vetëqeverisjes lokale ndahen, në përputhje me **vendimin e organit kompetent të njësisë së vetëqeverisjes lokale**, Këshillave Kombëtarë të cilët:

- 1) kanë **selinë në territorin e një njësie të vetëqeverisjes lokale;**
- 2) **përfaqësojnë pakicat kombëtare të cilat në popullsinë e njërive të vetëqeverisjes lokale arrijnë të paktën 10% të popullsisë së përgjithshme;**
- 3) **përfaqësojnë pakicat kombëtare, gjuha e të cilëve është në përdorim zyrtar në territorin e njësisë së vetëqeverisjes lokale.**

Me fjalë të tjera:

- sigurimi i fondeve për financimin e punës së Këshillave Kombëtarë **është detyrim i njërive të vetëqeverisjes lokale;**
- njësitë e vetëqeverisjes lokale e përmbushin këtë detyrim duke miratuar **Vendimin për buxhetin** i cili duhet të parashikojë vijën e buxhetit dhe shumën e fondeve të alokuara për financimin e punës së Këshillave Kombëtarë, **Vendimin për shpërndarjen** dhe **kriteret për shpërndarjen.**

## 5. KËSHILLAT KOMBËTARË NË FUSHËN E ARSIMIT

Duke folur me kusht, nëse një krahasim është fare i mundshëm dhe i përshtatshëm, fusha e arsimit është fusha më e rëndësishme në të cilën Këshillave Kombëtarë u është besuar ushtrimi i autoritetit publik. Numri dhe rëndësia e tyre janë të mëdha dhe nëse bëhen në mënyrë korrekte dhe në kohën e duhur, ato mundësojnë një ndikim të përshtatshëm në vendimet kryesore, në masën që çdo formë e vetëqeverisjes mund ta ketë atë ndikim.

E drejta e personave pjesë të pakicave kombëtare për arsimim në gjuhën dhe shkrimin e tyre është kategori kushtetuese. Duke filluar nga Kushtetuta e deri te ligji në fushën e arsimit, ekzistojnë dy kategori arsimi për pjesëtarët e pakicave kombëtare, në varësi të faktit se kush është pronar dhe themelues i institucioneve arsimore.

### **Kushtetuta e Republikës së Serbisë**

("Gazeta Zyrtare e RS", nr. 98/2006)

#### **"E drejta për të ruajtur veçantinë**

Neni 79

Anëtarët e pakicave kombëtare kanë të drejtën e: .....

**a. arsimimit në gjuhën e tyre në institucione shtetërore dhe në institucione të krahinave autonome**

**b. krijimit të institucioneve arsimore private."**

Sipas fushëveprimit dhe mënyrës në të cilën ushtrohet kjo e drejtë, ne dallojmë tre lloje arsimi:

- e drejta për arsimimin në tërësi të personave që u përkasin pakicave kombëtare **në gjuhën amtare dhe shkrimin e tyre,**
- e drejta për t'u arsimuar **përmes mësimiit dygjuhësh (në gjuhën dhe shkrimin e pakicës kombëtare dhe në gjuhën dhe shkrimin serb)** dhe
- e drejta për **mësimin e gjuhës amtare dhe shkrimiit përmes studimit të lëndës "Gjuha e pakicës kombëtare me elementë të kulturës kombëtare".**

### **Ligji për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Pakicave Kombëtare**

("Gazeta Zyrtare e RFJ", nr. 11/2002, "Gazeta Zyrtare e Serbisë dhe Malit të Zi", nr. 1/2003 - Karta Kushtetuese dhe "Gazeta Zyrtare e RS", nr. 72/2009 - Ligj tj, 97/2013 - vendimi i GJK dhe 47/2018)

#### **"Shkollimi në gjuhën amtare**

Neni 13

Anëtarët e pakicave kombëtare kanë të drejtën e **edukimit dhe arsimimit në gjuhën, pra të folurin e tyre** në institucionet .....

### **Ligji mbi Bazat e Sistemit Arsimor dhe Edukues**

("Gazeta Zyrtare e RS", Nr. 88/2017, 27/2018 - ligji tj, 10/2019, 27/2018 - ligji tj. dhe 6/2020)

#### **"Përdorimi i gjuhës**

Neni 5

..... Për anëtarët e një pakice kombëtare, puna arsimore-edukuese kryhet **në gjuhën, pra në të folurin dhe shkrimin** e pakicës kombëtare."

E drejta për arsimim në gjuhën dhe shkrimin e pakicës kombëtare garantohet **në të gjitha nivelet e arsimit:**

- në **institucionet parashkollore,**
- shkollat **fillore,**
- shkollat **e mesme** dhe,
- **institucionet e arsimit të lartë** (fakultetet dhe shkollat e larta të studimeve profesionale).

Të gjitha kompetencat që u janë besuar Këshillave Kombëtarë mund të ndahen, sipas natyrës dhe përmbajtjes së tyre ligjore, në:

- **themeluese dhe/ose administruese,**
- **pjesëmarrja në menaxhimin e institucioneve përmes dhënies së mendimeve dhe sugjerimeve,**
- **pjesëmarrja në zhvillimin dhe miratimin e kurrikulave për arsimin dhe edukimin, domethënë përmbajtjeve për lëndët që shprehin specifikën e një pakice kombëtare,**
- **pjesëmarrja në përzgjedhjen dhe sigurimin e teksteve shkollore dhe mjeteve mësimore dhe**
- **kompetenca të tjera në fushën e arsimit.**

Në kuadër të secilit prej këtyre grupeve, ka një numër kompetencash specifike. Praktika dhe të dhënat e deritanishme tregojnë se një numër i tyre nuk janë kryer sepse nuk ka nevojë për to ose nuk ka kapacitete të mjaftueshme për zbatimin cilësor të tyre, ndërsa pjesa tjetër kryhen në mënyra të ndryshme, në varësi të Këshillit Kombëtar konkret.

### **5.1. Dhënia e mendimit**

Kompetencat e Këshillave Kombëtarë për të dhënë lloje të ndryshme opinionesh është një nga ato kompetenca publike për ushtrimin e të cilave ekziston një nevojë konstante dhe e shpeshtë.

## **Ligji për Këshillat Kombëtarë të Pakicave Kombëtare**

("Gazeta Zyrtare e RS", nr. 72/2009, 20/2014 - vendimi i GJK, 55/2014 dhe 47/2018)

### **"Pjesëmarrja në menaxhimin e institucioneve**

Neni 12

Në **institucionet e edukimit dhe arsimit parashkollor, arsimit fillor dhe të mesëm**, themelues i të cilave është ....., Këshilli Kombëtar:

1. jep **mendim mbi kandidatët e propozuar për anëtarë të bordit administrativ ose shkollor - përfaqësues të njësisë së vetëqeverisjes lokale, .....**

3. jep **mendim për kandidatin për drejtor të institucionit .....**

Në **institucionet e standardit të nxënësve dhe studentëve** themeluesi i të cilave është ....., Këshilli Kombëtar:

1. .... jep **mendim për kandidatët e tjerë për anëtarë të bordit të drejtorëve të institucioneve standardit të nxënësve** selia e të cilëve është në territorin e një njësie të vetëqeverisjes vendore në të cilën gjuha e një pakice kombëtare është në përdorim zyrtar,

2. .... jep **mendim për kandidatët për anëtarë të bordit të drejtorëve të institucioneve standardit të studentëve** selia e të cilëve është në territorin e një njësie të vetëqeverisjes vendore në të cilën gjuha e një pakice kombëtare është në përdorim zyrtar,

3. .... jep **mendim për procedurën e zgjedhjes së drejtorit të institucionit të standardit të nxënësve dhe studentëve** selia e të cilëve është në territorin e një njësie të vetëqeverisjes lokale në të cilën gjuha e një pakice kombëtare është në përdorim zyrtar,

4. jep **mendim për procedurën e shkarkimit të drejtorit dhe anëtarëve të organit drejtues.....**



**Në fushën e arsimit të lartë në institucione, Këshilli Kombëtar:**

2. jep **mendim mbi kandidatët e propozuar për organin administrues dhe organin drejtues të institucionit të arsimit të lartë** në të cilin mësimi zhvillohet tërësisht ose pjesërisht në gjuhën e pakicës kombëtare.

### **Planet dhe programet e mësimdhënies dhe mësimore**

Neni 13

3. jep mendimin për **ministrin përgjegjës për arsimin dhe edukimin mbi kurrikulat e gjuhës serbe si gjuhë jo amtare,**

5. jep **mendimin mbi programin shkollor dhe arsimor të institucioneve të cilat janë përcaktuar të jenë të një rëndësie të veçantë për pakicën kombëtare.**

### **Librat shkollorë dhe mjetet mësimore**

Neni 14

- **Këshilli Kombëtar jep pëlqimin paraprak në procedurën e miratimit të dorëshkrimit të teksteve shkollore, manualeve, mjeteve shtesë mësimore, mjeteve mësimore ndihmë, mjeteve didaktike dhe atyre didaktike të lojës në gjuhën dhe shkrimin e pakicës kombëtare .....** "

Brenda këtij autorizimi, një nga më të pranishmit është autorizimi i Këshillit Kombëtar për të dhënë **një mendim mbi kandidatin e propozuar për drejtor** të një institucioni arsimor parashkollor, respektivisht fillor dhe të mesëm.

### **Ligji mbi Bazat e Sistemit Arsimor dhe Edukues**

("Gazeta Zyrtare e RS", nr. 88/2017, 27/2018 - ligji tj, 10/2019, 27/2018  
- ligji tj. dhe 6/2020)

### **"Zgjedhja e drejtorit të institucionit**

Neni 123

- Konkursi për zgjedhjen e drejtorit **shpallet nga organi drejtues (Bordi Drejtues në institucionin parashkollor/Bordi i Shkollës në shkollën fillore ose të mesme),**
- Në një institucion në të cilin puna arsimore - edukative kryhet edhe në gjuhën e një pakice kombëtare, organi drejtues është i **detyruar/duhet të marrë mendimin e Këshillit Kombëtar të pakicës kombëtare,**
- Nëse Këshilli Kombëtar i një pakice kombëtare **nuk paraqet një mendim brenda 15 ditëve nga dita e marrjes së kërkesës, mendimi do të konsiderohet se është dhënë."**

E HËNË E DIEL	E MARTË	E MËRKURË	E ENJTE	E PREMTE	E SHTUNË
<b>Data e marrjes së kërkesës për dhënien e mendimit</b>					
		<b>X</b>  <b>MENDIMI</b>  <b>Dhënë/Marrë</b>			

Për të ushtruar këtë autoritet në mënyrë efikase dhe korrekte, është e rëndësishme të theksohet se:

- Detyrimi i Bordit Drejtues për **marrjen e mendimit të Këshillit Kombëtar të një pakice kombëtare** përfshin detyrimin për **paraqitjen e një kërkesë për mendim për kandidatin e**

**propozuar, me dokumentacionin dhe aplikimet e nevojshme, Këshillit Kombëtar,**

- Paraqitja e një kërkesë për mendim duhet **të jetë në kohë në mënyrë që Këshilli Kombëtar të ketë kohë të mjaftueshme për të shqyrtuar kërkesën e paraqitur, aplikimet e paraqitura dhe dokumentacionin mbështetës,**
"Në bordin drejtues të një institucioni kulturor ..... për të cilin **me ndryshimin e aktit themelues përcaktohet se është me rëndësi të veçantë për ruajtjen, promovimin dhe zhvillimin e identitetit kulturor dhe ruajtjen e identitetit kombëtar të një pakice kombëtare, të paktën një anëtar i Bordit Drejtues do të emërohet me propozim të Këshillit Kombëtar përkatës .....**"

## **7.2. Dhënia e mendimit**

Kompetencat e Këshillave Kombëtarë për të dhënë lloje të ndryshme opinionesh është një nga ato kompetenca për ushtrimin e të cilave ekziston një nevojë konstante dhe e shpeshtë.

### **Ligji për Këshillat Kombëtarë të Pakicave Kombëtare**

("Gazeta Zyrtare e RS", nr. 72/2009, 20/2014 - vendimi i GJK, 55/2014 dhe 47/2018)

### **"Pjesëmarrja në menaxhimin e institucioneve**

Neni 17

Në institucionet kulturore për të cilat **me ndryshim të aktit themelues është përcaktuar se kanë rëndësi të veçantë për pakicën kombëtare**,  
Këshilli Kombëtar: .....

2. jep mendim **për anëtarët e propozuar të bordit drejtues** të institucionit,

3. jep mendim **për procedurën e shkarkimit të drejtorit të institucionit** ...."

Megjithatë, praktika ka treguar se vitet e fundit, kompetenca më i rëndësishme në jetën e përditshme të pjesëtarëve të pakicave kombëtare është ajo e dhënies të një mendimi krejt ndryshe.

**Ligji për Këshillat Kombëtarë të Pakicave Kombëtare**

("Gazeta Zyrtare e RS", nr. 72/2009, 20/2014 - vendimi i GJK, 55/2014 dhe 47/2018)

**"Kompetenca të tjera në fushën e kulturës**

Neni 18

Këshilli Kombëtar: .....

10. jep **propozimin për shpërndarjen e fondeve të akorduara me konkurs publik nga buxheti** i Republikës, krahinës autonome ose njësisë së vetëqeverisjes lokale, institucioneve, manifestimeve dhe shoqatave të pakicave kombëtare në fushën e kulturës, ... "

**Ligji për Kulturën**

("Gazeta Zyrtare e RS", nr. 72/2009, 13/2016,30/2016 - amend. dhe 6/2020)

## "Financimi dhe bashkëfinancimi i projekteve kulturore

Neni 76

Këshilli Kombëtar i pakicës kombëtare jep **propozimin për shpërndarjen e fondeve të akorduara me konkurs publik nga buxheti** i Republikës, krahinës autonome ose njësisë së vetëqeverisjes lokale, institucioneve, manifestimeve dhe shoqatave të pakicave kombëtare në fushën e kulturës .....

Dispozitat e ligjit që përcaktojnë këtë kompetencë të rëndësishme nuk janë të përcaktuara në mënyrë të atillë që të lejojnë zbatimin e drejtpërdrejtë. Prandaj, për zbatimin efikas të tij, përmbajtja e aktit nënligjor është shumë e rëndësishme. Ai përmban të gjithë informacionin e nevojshëm:

- për **mbledhjen e propozimeve për financimin, përkatësisht bashkëfinancimin e projekteve** në kulturë, të gjitha organet kompetente (Ministria e Kulturës dhe Informimit, Sekretariati Krahinor për Kulturë, organet e njësisë të vetëqeverisjes lokale) duhet të **shpallin një konkurs publik,**
- konkursi publik duhet të **shpallet të paktën një herë në vit,**
- autoritetet kompetente duhet të **publikojnë konkursin publik në faqen e tyre zyrtare të internetit dhe të paktën në një media të shtypit ditor të botuar në territorin e përfshirë nga konkursi,**
- afati për dorëzimin e aplikimeve **nuk mund të jetë më i shkurtër se 30 ditë nga dita e publikimit në gazetën ditore,**
- **të drejtën për të marrë pjesë** në konkurs kanë **institucionet, shoqatat artistike dhe të tjera, individët dhe subjektet e tjera të kulturës,**
- aplikimet për konkurs dorëzohen në **një formular të veçantë** i cili është **pjesë përbërëse e dokumentacionit të konkursit** dhe është **i disponueshëm në faqen zyrtare të internetit** të autoritetit kompetent,
- është e nevojshme që aplikimi të jetë **i plotë, i plotësuar siç duhet, me një përshkrim të detajuar dhe të arsyetuar të**

- projektit, me buxhet të përpunuar dhe të saktë, me të dhëna të sakta dhe të plota për kapacitetet e aplikantit,
- vlerësimi i projekteve bëhet nga secili anëtar i komisionit për secilin projekt veçmas, dhe komisioni është i detyruar të bëjë një arsyetim me shkrim duke treguar arsyet e pranimit ose mospranimit të projekteve.

**Rregullorja për kriteret, standardet dhe mënyrën e përzgjedhjes së projekteve kulturore të financuara dhe të bashkëfinancuara nga Buxheti i Republikës së Serbisë, Krahina Autonome, përkatësisht Njësitë e Vetëqeverisjes Lokale**

("Gazeta Zyrtare e RS", nr. 105/2016 dhe 112/2017)

Neni 3

"Kriteret në bazën e të cilave do të vlerësohen projektet ...

- 1) **pajtueshmëria e projektit me interesin e përgjithshëm në kulturë dhe me prioritetet e konkursit,**
- 2) **sa inovativ është projekti në cilësi dhe përmbajtje,**
- 3) **kapacitetet** e nevojshme për zbatimin e projektit, pikërisht:
  1. **kapacitetet profesionale dhe artistike,**
  2. burime të tjera **të nevojshme.**
- 4) **plani financiar** - përpunimi, pajtueshmëria me planin e veprimit, aspekti ekonomik dhe përfshirja e disa burimeve të financimit,
- 5) **shkalla e ndikimit në cilësi"**



## Model i Mendimit/Vendimit për dhënien e Mendimit

**KËSHILLI KOMBËTAR I**

**PAKICËS KOMBËTARE** \_\_\_\_\_

**Republika e Serbisë**

**Numri:** \_\_\_\_\_

**Data:** \_\_\_\_\_

**Vendi:** \_\_\_\_\_

**MINISTRIA E KULTURËS DHE INFORMIMIT/SEKRETARIAT KRAHINOR  
PËR \_\_\_\_\_/QYTETI/BASHKIA**

**ADMINISTRATA E QYTETIT/BASHKIAKE**

**Sekretariati Komunal/i qytetit për \_\_\_\_\_<sup>35</sup>**

**Rruga \_\_\_\_\_ nr. \_\_\_\_\_**

Në bazë të nenit 76, paragrafit 5 të Ligjit për Kulturën ("Gazeta Zyrtare e RS", nr. 72/2009, 13/2016, dhe 30/2016) dhe nenit 18, paragrafi 1 pika 10 e Ligjit për Këshillat Kombëtarë të Pakicave Kombëtare ("Gazeta Zyrtare e RS", nr. 72/2009, 20/2014 - Vendimi i GJK, 55/2014 dhe 47/2018), dhe në përputhje me nenin \_\_\_\_ të Statutit të Këshillit Kombëtar të pakicës kombëtare \_\_\_\_\_ (Numri: \_\_\_\_\_ i \_\_\_\_\_ 20\_\_\_\_\_) (në tekstin e mëtejme: Statuti), dhe me nenin \_\_\_\_ të Rregullores për Punën e Këshillit Kombëtar të pakicës kombëtare (Numër: \_\_\_\_\_ të datës \_\_\_\_\_ 20\_\_\_\_\_) (në tekstin e mëtejme:

---

<sup>35</sup> Zgjidhni një nga opsionet e ofruara në varësi të situatës konkrete, d.m.th. se kujt i dërgohet akti.

Rregullorja)<sup>36</sup>, Këshilli Kombëtar i pakicës kombëtare \_\_\_\_\_ (në tekstin e mëtejshëm: Këshilli/Bordi ekzekutiv), në mbledhjen e mbajtur më \_\_\_\_\_ 20 \_\_\_\_\_, ka marrë këtë

## MENDIM/VENDIM

**për**

**dhënien e një mendimi për propozimin për shpërndarjen e fondeve të alokuara përmes një konkursi publik për financimin dhe bashkëfinancimin e projekteve në fushën e kulturës**

I

Jepet mendimi **pozitiv/negativ** dhe **rekomandohet që të alokohen fonde për projektin** \_\_\_\_\_ (emërtimi ose emri i aplikantit) nën emrin " \_\_\_\_\_ " (emri i projektit) i dërguar në konkursin publik të Ministrisë së Kulturës dhe informimit/të Sekretariatit Krahinor për \_\_\_\_\_/të qytetit/komunës \_\_\_\_\_ për financimin dhe bashkëfinancimin e projekteve kulturore.

/

Jepet mendimi **pozitiv/negativ** dhe **rekomandohet alokimi i fonde për këto projekte që janë** dërguar në konkursin publik të Ministrisë së Kulturës dhe informimit/të Sekretariatit Krahinor për \_\_\_\_\_/të qytetit/komunës \_\_\_\_\_ për financimin dhe bashkëfinancimin e projekteve kulturore.<sup>37</sup>

---

<sup>36</sup> Zgjidhni të gjitha ose disa nga opsionet e ofruara, në varësi të organizimit të brendshëm dhe mënyrës së punës dhe vendimmarrjes së Këshillit Kombëtar të pakicës kombëtare.

<sup>37</sup> Zgjidhni një nga opsionet e ofruara në varësi të faktit nëse është e nevojshme të jepni një mendim për një ose më shumë projekte të propozuara për shpërndarjen e fondeve.

Nr. radh.	Emri i projektit	Emri i aplikantit	Arsyetime <sup>38</sup>
_____	_____	_____	_____
_____	_____	_____	_____
_____	_____	_____	_____
_____	_____	_____	_____
_____	_____	_____	_____

## II

Vendimi t'i dorëzohet Kryetarit të Këshillit për miratim në seancën e parë të radhës të Këshillit<sup>39</sup>/Ministrisë së Kulturës/Sekretariatit Krahinor për \_\_\_\_\_/Qytetit/Komunës Sekretariatit për \_\_\_\_\_<sup>40</sup>.

<sup>38</sup> P.sh. Këshilli rekomandon që \_\_\_\_\_ të mbështesë financiarisht zbatimin e një projekti të rëndësishëm për ruajtjen/zhvillimin/promovimin e artit dhe kulturës \_\_\_\_\_, konceptin cilësor dhe qasjen ndaj temës, shtrirjen dhe rëndësinë e temës, mënyrën se si trajtohen temat, kohëzgjatja disavejeçare, angazhimi i një numri të madh anëtarësh të rinj të pakicës kombëtare \_\_\_\_\_, sepse ky është një manifestim tradicional i pakicës kombëtare \_\_\_\_\_, me realizim të mirë të projekteve të mëparshme të aplikantit, sepse është një manifestim i një rëndësie të madhe për ruajtjen e identitetit kulturor \_\_\_\_\_.

<sup>39</sup> Në bazë të nenit 7, paragrafit 7 të Ligjit përcaktohet që Këshilli miraton vendimin e marrë nga Bordi Ekzekutiv në seancën e radhës, por gjithashtu që vendimi i Bordit Ekzekutiv mbetet në fuqi edhe nëse Këshilli nuk e miraton atë. Në rast mosmiratimi të vendimit të Bordit Ekzekutiv, mandati i Bordit Ekzekutiv përfundon, por vendimi mbetet në fuqi. Prandaj, vendimet e tilla të marra nga Bordi Ekzekutiv janë, të paktën sipas dispozitave aktuale, të vlefshme dhe mund t'i paraqiten kërkuesit të mendimit/propozimit/pëlqimit, dhe të publikohen në tabelën e njoftimeve dhe faqen zyrtare të internetit të Këshillit.

<sup>40</sup> Zgjidhni një nga opsionet e ofruara në varësi të faktit nëse Këshilli, me Statutin e tij, i ka besuar apo jo Bordit Ekzekutiv të vendosë për çështje të caktuara që lidhen me ushtrimin e kompetencave të Këshillit Kombëtar të parashikuara me ligj.

### III<sup>41</sup>

Vendimi të publikohet në tabelën e njoftimeve dhe në faqen zyrtare të internetit të Këshillit.

### **Arsyetimi<sup>42</sup>**

**VËREJTJE:** Komisionet që marrin vendimin për shpërndarjen e fondeve të akorduara nëpërmjet konkursit publik janë të detyruar të shpjegojnë në mënyrë të detajuar dhe të plotë arsyet dhe faktet në bazë të cilave e kanë bërë këtë në Arsyetimin e vendimit të tyre, kur devijojnë nga Propozimi/Mendimi i Këshillave Kombëtarë. Çdo veprim i kundërt e bën të pakuptimtë çdo pjesëmarrje të Këshillave Kombëtarë në këto procedura.

---

<sup>41</sup> Ky nen do të zbatohet vetëm në rastet kur Mendimi/Vendimi është miratuar nga Këshilli. Nëse bëhet fjalë për një Mendim/Vendim të marrë nga Bordi Ekzekutiv, i njëjti nen duhet të ndodhet në vendimin për miratimin e tij nga Këshilli.

<sup>42</sup> Në përputhje me parimin e qeverisjes së mirë, çdo akt ligjor që vendos për të drejtat dhe detyrimet, si dhe ai i miratuar me ushtrimin e autoriteteve publike, duhet të ketë një arsyetim, sidomos nëse procesverbali i seancës në të cilën është miratuar nuk është shtojcë e domosdoshme e tij. Arsyetimi duhet të përmbajë, dhe të bëjë të disponueshme për publikun, faktet vendimtare pse dhe në çfarë mënyre është miratuar akti juridik përkatës, si p.sh. në Modelin e Vendimit për ndryshimin e të dhënave nr. 1a.

## 8. KËSHILLAT KOMBËTARË NË FUSHËN E INFORMIMIT

Fusha e informacionit është në shumë mënyra e ngjashme me fushën e kulturës kur bëhet fjalë për kompetencat e Këshillave Kombëtarë. Kjo është një fushë:

- në të cilën, përveç funksionit bazë - **informimit**, ekziston edhe një funksion dytësor, por jo më pak i rëndësishëm për të kontribuar në ruajtjen e identitetit kulturor dhe gjuhësor të pakicave kombëtare,
- ku kërkohet dhe pritet **qasja proaktive** e Këshillave Kombëtarë,
- në të cilën **përgjegjësia për ushtrimin e plotë, efikas dhe të duhur ndahet në mënyrë të barabartë ndërmjet autoriteteve publike dhe Këshillave Kombëtarë.**

E drejta për informim është gjithashtu një kategori kushtetuese. Pjesëtarët e pakicave kombëtare në Serbi gëzojnë garanci të dyfishta për të drejtën e informimit. Njëra është e drejta e përgjithshme për informim e garantuar për të gjithë qytetarët, ndërsa tjetra është e drejta për informim në gjuhën amtare, qëllimi i vetëm i së cilës është ruajtja e specifikave të pakicave kombëtare.

	<p style="text-align: center;"><b>Kushtetuta</b> ("Gazeta Zyrtare e RS", nr. 98/2006)</p> <p style="text-align: center;"><b>"E drejta për informim</b> Neni 51</p> <p style="text-align: center;"><b>"Çdokush ka të drejtë të informohet me vërtetësi, plotësisht dhe në kohën e duhur për çështje me rëndësi publike, dhe mediat janë të detyruara ta respektojnë këtë të drejtë."</b></p> <p style="text-align: center;"><b>E drejta për të ruajtur veçantinë</b> Neni 79</p>
--	---

"Anëtarët e pakicave kombëtare kanë të drejtë të:

- **informohen në mënyrë të plotë, në kohë dhe të paanshëm në gjuhën e tyre;**
- **shprehin, marrin dhe shkëmbejnë informacion dhe ide në gjuhën e tyre;**
- **krijojnë mjetet e veta të informimit."**

Të gjitha kompetencat që u janë besuar Këshillave Kombëtare mund të ndahen, sipas natyrës dhe përmbajtjes së tyre ligjore, në:

- **themeluese dhe/ose administruese,**
- **pjesëmarrje në menaxhimin e institucioneve (Propozimi dhe dhënia e mendimeve),**
- **pjesëmarrja në marrjen e vendimeve, dhe**
- **kompetenca të tjera në fushën e informimit.**

Në kuadër të secilit prej këtyre grupeve, ka një numër të madh kompetencash specifike. Megjithatë, praktika ka treguar se më së shpeshti ushtrohet një nga kompetencat nga grupi i fundit, ndonëse nuk është i karakterit strategjik por operacional. Kjo nuk duhet të jetë befusuese sepse fusha e informimit ka një karakteristikë tjetër - nevojën për financim të vazhdueshëm dhe të përshtatshëm. Një nga mënyrat më të rëndësishme për të ushtruar të drejtën për të informuar qytetarët që u përkasin pakicave kombëtare është përmes konkurseve të ndryshme për projekte të shpallura rregullisht nga Ministria e Kulturës dhe Informimit, Sekretariati Krahinor për Informim dhe njësitë e vetëqeverisjes lokale. Përveç kësaj, ata kanë qasje në një burim shtesë të ardhurash - Fondi Buxhetor për Pakicat Kombëtare, i cili deri vonë menaxhohej nga Ministria e Administratës Shtetërore dhe Vetëqeverisjes Lokale, ndërsa sipas Ligjit të ri për ministritë duhet të jetë në kompetencën **e Ministrisë së të Drejtave të Njeriut dhe të Pakicave dhe Dialogut Shoqëror.**

## **Ligji për Këshillat Kombëtarë të Pakicave Kombëtare**

("Gazeta Zyrtare e RS", nr. 72/2009, 20/2014 - vendimi i GJK, 55/2014 dhe 47/2018)

### **"Fondi buxhetor për pakicat kombëtare**

Neni 119

Fondet nga Fondi Buxhetor jepen përmes **një tenderi publik për financimin e programeve dhe projekteve në fushën e kulturës, arsimit, informacionit dhe përdorimit zyrtar të gjuhës dhe shkrimit** .....

**VËREJTJE: Fusha prioritare për të cilën Fondi Buxhetor do të sigurojë fonde përcaktohet në mbledhjen e Këshillit për Pakicat Kombëtare, në bazë të rekomandimeve të KKKP-së, përkatësisht Koordinimit të Këshillave Kombëtarë të Pakicave Kombëtare.**

Sa i përket dhënies së opinioneve, vlen të përmendim disa gjëra:

- Këshillat kombëtarë mund të ndikojnë ndjeshëm **me autoritetin dhe cilësinë e opinioneve** të tyre që japin për projektet në fushën e informimit,
- Qëndrimi i tyre për këtë çështje **përgjithësisht respektohet,**
- **Konkurset për financimin dhe bashkëfinancimin janë publike,**
- Organi që shpall konkursin **është i detyruar të marrë mendimin e Këshillit Kombëtar,**
- **Supozohet** se ky organ do t'u japë **dokumentacionin e plotë këshillave kombëtarë në kohën e duhur,** në mënyrë që ata të kenë kohë të mjaftueshme dhe mbi çfarë baze të japin mendim,
- Gjatë dhënies së opinionit duhet pasur parasysh se praktika ka treguar se **problemi më i madh deri tani është zbatimi i projekteve të cilave u janë miratuar fondet.**

### **Ligji për Këshillat Kombëtarë të Pakicave Kombëtare**

("Gazeta Zyrtare e RS", nr. 72/2009, 20/2014 - vendimi i GJK, 55/2014 dhe 47/2018)

#### **"Kompetenca të tjera në fushën e informimit**

Neni 21

Këshilli Kombëtar: .....

2. jep **propozimin për alokimin e fondeve** për projektet e paraqitura në një tender publik të shpallur nga një autoritet publik, **me qëllim rritjen e cilësisë së informimit për personat që u përkasin pakicave kombëtare; ....**"

### **Ligji për Informimin Publik dhe Mediat**

("Gazeta Zyrtare e RS", nr. 83/2014, 58/2015 dhe 12/2016 - interpretimi autentik)

#### **"Ushtrimi i të drejtës të pakicave kombëtare për informim**

Neni 13

"Për të mundësuar **ushtrimin e së drejtës së pakicave kombëtare për informim në gjuhën e tyre, dhe për të kultivuar kulturën dhe identitetin e tyre, .....** siguron një pjesë të fondeve, **nëpërmjet bashkëfinancimit** ose kushteve të tjera për punën e mediave që publikojnë informacione në gjuhët e pakicave kombëtare .....

#### **Komisioni i Konkursit**

Neni 24

..... Mendimi i Këshillit Kombëtar përkatës të pakicës kombëtare për projektet që paraqiten në konkursin që shpallet për të ngritur cilësinë e



**informimit për anëtarët e pakicave kombëtare, duhet të merret domosdo."**

**Model i Mendimit/Vendimit për dhënien e Mendimit**

**KËSHILLI KOMBËTAR I**

**PAKICËS KOMBËTARE** \_\_\_\_\_

**Republika e Serbisë**

**Numri:** \_\_\_\_\_

**Data:** \_\_\_\_\_

**Vendi:** \_\_\_\_\_

**MINISTRIA E KULTURËS DHE INFORMIMIT/SEKRETARIAT KRAHINOR  
PËR INFORMIM/QYTETI/BASHKIA** \_\_\_\_\_

**Administrata e qytetit/bashkiake**

**Sekretariati Komunal/i qytetit për** \_\_\_\_\_

**Rruga** \_\_\_\_\_ **nr.** \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

Në bazë të nenit 24, paragrafit 2 të Ligjit për Informimin publike dhe Mediat ("Gazeta Zyrtare e RS", nr. 83/2014, 58/2015, dhe 12/2016) dhe nenit 21, paragrafi 1 pika 2 e Ligjit për Këshillat Kombëtarë të Pakicave Kombëtare ("Gazeta Zyrtare e RS", nr. 72/2009, 20/2014 - Vendimi i GJK, 55/2014 dhe 47/2018), dhe në përputhje me nenin \_\_\_ të Statutit të Këshillit Kombëtar të pakicës kombëtare \_\_\_\_\_ (Numri: \_\_\_\_\_ i \_\_\_\_\_ 20\_\_\_\_\_) (në tekstin e mëtejme: Statuti), dhe me nenin \_\_\_ të Rregullores për Punën e Këshillit

Kombëtar të pakicës kombëtare (Numër: \_\_\_\_\_ të datës \_\_\_\_\_ 20\_\_\_\_\_)<sup>43</sup>(në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja), Këshilli Kombëtar i pakicës kombëtare \_\_\_\_\_ (në tekstin e mëtejshëm: Këshilli/Bordi ekzekutiv), në mbledhjen e mbajtur më \_\_\_\_\_ 20 \_\_\_\_\_, ka marrë këtë

## MENDIM/VENDIM

për

**dhënien e një mendimi për propozimin për shpërndarjen e fondeve të alokuara përmes një konkursi publik për financimin dhe bashkëfinancimin e projekteve në fushën e informimit**

I

Jepet mendimi **pozitiv/negativ** dhe **rekomandohet që të alokohen fonde për projektin** \_\_\_\_\_ (emërtimi ose emri i aplikantit) nën emrin " \_\_\_\_\_ " (emri i projektit) i dërguar në konkursin publik të Ministrisë së Kulturës dhe informimit/të Sekretariatit Krahinor për informim/të qytetit/komunës \_\_\_\_\_ për financimin dhe bashkëfinancimin e projekteve kulturore.

/

Jepet mendimi **pozitiv/negativ** dhe **rekomandohet alokimi i fonde për këto projekte që janë** dërguar në konkursin publik të Ministrisë së Kulturës dhe informimit/të Sekretariatit Krahinor për informim/të qytetit/komunës \_\_\_\_\_ për financimin dhe bashkëfinancimin e projekteve kulturore.<sup>44</sup>

---

<sup>43</sup> Zgjidhni të gjitha ose disa nga opsionet e ofruara, në varësi të organizimit të brendshëm dhe mënyrës së punës dhe vendimmarrjes së Këshillit Kombëtar të pakicës kombëtare.

<sup>44</sup> Zgjidhni një nga opsionet e ofruara në varësi të faktit nëse është e nevojshme të jepni një mendim për një ose më shumë projekte të propozuara për shpërndarjen e fondeve.

## II

Vendimi t'i dorëzohet Kryetarit të Këshillit për miratim në seancën e parë të radhës të Këshillit<sup>45</sup>/Ministrisë së Kulturës/Sekretariatit Krahinor për informim/Qytetit/Komunës \_\_\_\_\_ Sekretariatit për \_\_\_\_\_.<sup>46</sup>

## III<sup>47</sup>

Vendimi të publikohet në tabelën e njoftimeve dhe në faqen zyrtare të internetit të Këshillit.

### **Arsyetimi<sup>48</sup>**

---

<sup>45</sup> Në bazë të nenit 7, paragrafit 7 të Ligjit përcaktohet që Këshilli miraton vendimin e marrë nga Bordi Ekzekutiv në seancën e radhës, por gjithashtu që vendimi i Bordit Ekzekutiv mbetet në fuqi edhe nëse Këshilli nuk e miraton atë. Në rast mosmiratimi të vendimit të Bordit Ekzekutiv, mandati i Bordit Ekzekutiv përfundon, por vendimi mbetet në fuqi. Prandaj, vendimet e tilla të marra nga Bordi Ekzekutiv janë, të paktën sipas dispozitave aktuale, të vlefshme dhe mund t'i paraqiten kërkuesit të mendimit/propozimit/pëlqimit, dhe të publikohen në tabelën e njoftimeve dhe faqen zyrtare të internetit të Këshillit.

<sup>46</sup> Zgjidhni një nga opsionet e ofruara në varësi të faktit nëse Këshilli, me Statutin e tij, i ka besuar apo jo Bordit Ekzekutiv të vendosë për çështje të caktuara që lidhen me ushtrimin e kompetencave të Këshillit Kombëtar të parashikuara me ligj.

<sup>47</sup> Ky nen do të zbatohet vetëm në rastet kur Mendimi/Vendimi është miratuar nga Këshilli i Pakicës Kombëtare. Nëse bëhet fjalë për një Mendim/Vendim të marrë nga Bordi Ekzekutiv, i njëjti nen duhet të ndodhet në vendimin për miratimin e tij nga Këshilli.

<sup>48</sup> Në përputhje me parimin e qeverisjes së mirë, çdo akt ligjor që vendos për të drejtat dhe detyrimet, si dhe ai i miratuar me ushtrimin e autoriteteve publike, duhet të ketë një arsyetim, sidomos nëse procesverbali i seancës në të cilën është miratuar nuk është shtojcë e domosdoshme e tij. Arsyetimi duhet të përmbajë, dhe të bëjë të disponueshme për publikun, faktet vendimtare pse dhe në çfarë mënyre është miratuar akti juridik përkatës, si p.sh. në Modelin e Vendimit për ndryshimin e të dhënave nr. 1a.

**VËREJTJE:** Komisionet që marrin vendimin për shpërndarjen e fondeve të akorduara nëpërmjet konkursit publik janë të detyruar të shpjegojnë në mënyrë të detajuar dhe të plotë arsyet dhe faktet në bazë të cilave e kanë bërë këtë në Arsyetimin e vendimit të tyre, kur devijojnë nga Propozimi/Mendimi i Këshillave Kombëtarë. Çdo veprim i kundërt e bën të pakuptimtë çdo pjesëmarrje të Këshillave Kombëtarë në këto procedura.

## 9. KËSHILLAT KOMBËTARË DHE AUTORITETET E PAVARUR

### 9.1. Mbrojtësi i Qytetarëve

Mbrojtësi i Qytetarëve ka një sërë kompetencash shumë të rëndësishme kur bëhet fjalë për ushtrimin e kompetencave publike të Këshillave Kombëtarë.

#### Ligji mbi Mbrojtësin e Qytetarëve

("Gazeta Zyrtare e RS", nr. 79/2005 dhe 54/2007)

"Neni 17

Mbrojtësi i Qytetarëve .... **kontrollon respektimin e të drejtave të qytetarëve**, konstaton shkeljet e kryera nga veprimet ose mosveprimet e organeve administrative ..... **kontrollon ligjshmërinë dhe rregullsinë e punës së organeve administrative ....**

Neni 18

Mbrojtësi i Qytetarëve ka të drejtë të **propozojë ligje** brenda kompetencës së tij.

Mbrojtësi i Qytetarëve është i autorizuar që t'i paraqesë **Qeverisë, përkatësisht Kuvendit iniciativë për ndryshime dhe plotësime të ligjit ...**

Mbrojtësi i Qytetarëve është i autorizuar t'i **japë mendim Qeverisë dhe Kuvendit për projektligjet dhe aktet nënligjore** në procedurën e zbatimit të dispozitave, nëse ato rregullojnë çështje që janë të rëndësishme për mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve.

Neni 19

Mbrojtësi i Qytetarëve është i autorizuar të **inicojë procedurën në Gjykatën Kushtetuese për vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së ligjeve, rregulloreve të tjera dhe akteve të përgjithshme.**

## Neni 20

Mbrojtësi i Qytetarëve është i autorizuar që publikisht të rekomandojë shkarkimin e zyrtarit përgjegjës për shkeljen e të drejtave të qytetarëve, gjegjësisht të iniciojë procedurë disiplinore ndaj punonjësit të organit administrativ i cili është drejtpërdrejt përgjegjës për shkeljen e bërë..."

Mbrojtësi i Qytetarëve vepron:

1. Në bazë të **ankesave** dhe/ose
2. sipas **iniciativës personale**.

Në mënyrë që ky mekanizëm mbrojtës të jetë efikas, është e nevojshme të plotësohen disa kushte:

3. Mbrojtësi i Qytetarëve duhet të jetë **hapi i fundit dhe jo i parë** në mbrojtjen e të drejtës që dikujt i është shkelur,
4. Prandaj **përpara se të paraqesë një ankesë**, kërkuesi **duhet të përpiqet të mbrojë të drejtat e tij në procedurat e duhura ligjore duke përdorur mjetet juridike që ka në dispozicion**,
5. Nëse nuk e bën këtë, Mbrojtësi i Qytetarëve **nuk do të fillojë procedurat mbi ankesën e paraqitur, por do të udhëzojë ankuesin se cilat mjete juridike janë në dispozicion të tij, dhe do ta udhëzojë atë të fillojë procedurat e duhura ligjore**,
6. Vetëm në raste të veçanta, Mbrojtësi i Qytetarëve do të fillojë procedurat edhe para se të jenë shterur të gjitha mjetet juridike (nëse do të shkaktohej **dëm i pariparueshëm, nëse është një ankesë për shkak të shkeljes së parimit të qeverisjes së mirë, qëndrim veçanërisht jokorrekt i autoriteteve ndaj ankimesit, punë jo në kohën e duhur ....**

Ankesa mund të bëhet nga:

**Ligji mbi Mbrojtësin e Qytetarëve**  
("Gazeta Zyrtare e RS", nr. 79/2005 dhe 54/2007)  
**"Neni 25**  
**Çdo person fizik ose juridik, vendas ose i huaj, i cili konsideron se i janë shkelur të drejtat me akt, veprim ose mosveprim të një organi administrativ...."**

Ankimi mund të bëhet jo më vonë se një vit nga cenimi i së drejtës, pra nga veprimi ose mosveprimi i fundit i organit administrativ.

Ky afat ndërpritet dhe fillon të llogaritet sërish me çdo veprim apo aktivitet qoftë të organit administrativ, qoftë të ankimuesit, p.sh. letër autoritetit në lidhje me mosveprimin e mëparshëm.

<b>X</b>	<b>365 ditë</b>	<b>Ankesë te Mbrojtësi i Qytetarëve</b>
	<b>12 muaj</b>	
	<b>1 vit</b>	

Këshillat Kombëtarë mund dhe duhet të paraqesin një ankesë te Mbrojtësi i Qytetarëve:

- 1) Kur u shkelen të drejtat, d.m.th. kur ata nuk janë në gjendje të ushtrojnë kompetencat që u janë besuar, ose autoritetet shtetërore nuk përmbushin detyrimet e veta ndaj tyre (**në emër të vet**),
- 2) Kur shkelen të **drejtat e pjesëtarëve** të pakicës kombëtare që ata përfaqësojnë (**në emër të pjesëtarëve të pakicës kombëtare**).

Këshillat kombëtarë mund ta bëjnë këtë sipas dy bazave ligjore.

### **Ligji mbi Mbrojtësin e Qytetarëve**

("Gazeta Zyrtare e RS", nr. 79/2005 dhe 54/2007)

"Neni 25

**Çdo person fizik ose juridik** që konsideron se ..... mund të bëjë një ankesë pranë Mbrojtësit të Qytetarëve."

### **Ligji për Këshillat Kombëtarë të Pakicave Kombëtare**

("Gazeta Zyrtare e RS", nr. 72/2009, 20/2014 - vendimi i GJK, 55/2014 dhe 47/2018)

#### **"1. Kompetencat e përgjithshme**

Neni 10

**Këshilli Kombëtar, .....**

**12) paraqet një ankesë të Mbrojtësi i Qytetarëve .....**, kur vlerëson se ka pasur një shkelje të së drejtës garantuar me kushtetutë dhe ligjërisht ....."

Ankesa dorëzohet **me shkrim ose përcillet me gojë e në procesverbal.**

Dorëzimi i ankesës **nuk paguhet**, d.m.th. mund të depozitohet pa paguar një tarifë ose ndonjë taksë tjetër.

**Këshilli Kombëtar nuk ka nevojë për pëlqim ose leje për të paraqitur një ankesë të Mbrojtësi i Qytetarëve.**

Ankesa mund të hartohet:

- në një **formë** të lirë dhe
- **duke plotësuar formularin e ankesës** i cili mund të gjendet në faqen zyrtare të internetit të Mbrojtësit të Qytetarëve.



Pavarësisht se si do të hartohet ankesa, është e rëndësishme të jetë:

- e qartë,
- e kuptueshme,
- precize,
- koncize dhe
- të përmbajë të dhëna **të sakta** dhe **të nevojshme**
  - o për **aplikantin** ose personin të cilit i është shkelur e drejta dhe/ose interesi
  - o për **atë që pretendohet se ka kryer shkeljen e të drejtave dhe/ose interesave**, dhe
  - o për **aktin dhe/ose veprimin/mosveprimin**.

## **9.2. Komisioneri për Mbrojtjen e Barazisë**

Ka shumë ngjashmëri në marrëdhëniet midis Këshillave Kombëtarë dhe Komisionerit për Mbrojtjen e Barazisë me marrëdhëniet midis Mbrojtësit të Qytetarëve dhe Këshillave Kombëtarë. Megjithatë, nuk është i papërfillshëm numri dhe rëndësia e dallimeve që ekzistojnë, të cilat janë pasojë e dallimeve në kompetencat e këtyre dy organeve të pavarura.

Domethënë, Komisioneri ka disa kompetenca që Mbrojtësi i Qytetarëve nuk i ka.

### **Ligji për Ndalimin e Diskriminimit**

("Gazeta Zyrtare e RS", nr. 22/2009)

#### **"Kompetencat e Komisionerit**

Neni 33

Komisioneri:

1. **merr dhe shqyrton ankesat për shkelje të ndalimit të diskriminimit ..... dhe vendos masa .....**;
3. **bën padi** për shkelje të ndalimit të diskriminimit, ..... dhe
4. **bën kallëzime për kundërvajtje për shkelje të ndalimit të diskriminimit"**

## Neni 38

Komisioneri **propozon zbatimin e procedurës së pajtimit**, në përputhje me ligjin që rregullon procedurën e ndërmjetësimit, **para ndërmarrjes së veprimeve të tjera procedurale."**

Në mënyrë që ky mekanizëm mbrojtës të jetë efikas, është e nevojshme të plotësohen disa kushte:

- Ankesa mund të paraqitet **vetëm për diskriminim** (shkelje e ndalimit të diskriminimit) **dhe jo për shkelje të lirive dhe të drejtave që mund të ekzistojnë, por që nuk kanë elemente diskriminimi** (ata janë objekt i punës së Mbrojtësit të Qytetarëve),
- Ankesa mund të bëhet nga:

### Rregullorja e Punës

("Gazeta Zyrtare e RS", nr. 34/2011)

#### "Personat e autorizuar për paraqitjen e ankesës

### Neni 15

Ankesa për diskriminim mund të bëhet nga:

- Çdo **person fizik ose juridik, ose grup personash që konsiderojnë se kanë qenë objekt diskriminimi;**
- **Një organizatë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, ose një person tjetër, në emër dhe me pëlqimin e një personi që konsideron se ka pësuar diskriminim;**
- Në rastin e **diskriminimit kundër një grupi personash, një organizatë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut mund të paraqesë një ankesë në emër të saj, pa pëlqimin e anëtarëve**

individualë."

Këshillat kombëtarë mund të paraqesin ankesë:

- në **emër të tyre** dhe
- në **emër të një personi që e konsideron veten të ketë qenë ose ka qenë** i diskriminuar.

Kur **parashtron një ankesë në emër të një personi që konsideron ose ka pësuar diskriminim**, dhe i cili është anëtar i pakicës përkatëse kombëtare, këshillat kombëtarë nuk kanë nevojë për pëlqimin e veçantë të atij personi, duke qenë se sipas Kushtetutës dhe ligjeve, këshillat kombëtarë përfaqësojnë një pakicë kombëtare dhe të gjithë anëtarët e saj.

Ankesa dorëzohet **me shkrim**. Vetëm **në raste të veçanta**, ajo mund të jepet **me gojë dhe për këtë të bëhet një procesverbal**.

Dorëzimi i ankesës **nuk paguhet**, d.m.th. mund të depozitohet pa paguar një tarifë ose ndonjë taksë tjetër.

Ankesa mund të dorëzohet kundër:

- Çdo **person fizik** që kryen një akt diskriminimi,
- Çdo **grupi personash** që kryen një akt diskriminimi,
- Çdo **person juridik** që kryen një akt diskriminimi, dhe
- Çdo **organi të pushtetit publik** që kryen një akt diskriminimi.

Paraqitja e një ankesë ka kuptim dhe mund të jetë e suksesshme vetëm nëse përmbushen disa kushte:

**Ligji për Ndalimin e Diskriminimit**

("Gazeta Zyrtare e RS", nr. 22/2009)

**"Neni 36**

..... nëse **procedura para gjykatës për të njëjtën çështje nuk është nisur ose nuk ka përfunduar ligjërisht.**"

**Gjithashtu, Komisioneri nuk do të veprojë:**

**Ligji për Ndalimin e Diskriminimit**

("Gazeta Zyrtare e RS", nr. 22/2009)

**"Neni 36**

- nëse **është e qartë se nuk ka shkelje të së drejtës për të cilën ankohet aplikanti,**
- nëse **ka vepruar tashmë për të njëjtën çështje dhe nuk është ofruar asnjë provë e re,**
- nëse konstaton se **për shkak të kalimit të kohës që kur është kryer shkelja, është e pamundur të arrihet qëllimi i procedimit."**

As autoriteti i Komisionerit për të nisur një proces gjyqësor **nuk është i pakushtëzuar**. Domethënë, që Komisioneri të mund të bëjë padi, është e nevojshme të plotësohet një kusht i veçantë.

**Ligji për Ndalimin e Diskriminimit**

("Gazeta Zyrtare e RS", nr. 22/2009)

**"Paditë e personave të tjerë**

Neni 46

**Paditë .....** mund të ngrihen nga **Komisioneri** dhe një organizatë që merret me mbrojtjen e të drejtave të njeriut, pikërisht të drejtave të një grupi të caktuar personash.

Nëse **trajtimi diskriminues zbatohet ekskluzivisht për një person të caktuar**, prokurorët mund të bëjnë **padi vetëm me pëlqimin e tij me shkrim."**

Komisionerit i **nevojitet pëlqimi i personit që konsideron se ka qenë ose ka pësuar diskriminim**, nëse pas shqyrtimit të ankesës konstaton se ka vend **për ngritjen e padisë.**

Pra, Komisioneri, për të nisur një proces gjyqësor ka nevojë për pëlqimin me shkrim të:

- **Këshillit Kombëtar** nëse **ka paraqitur një ankesë në emër të tij, sepse trajtimi diskriminues lidhet me Këshillin Kombëtar si person juridik,**
- **Anëtarit të pakicës kombëtare** nëse **Këshilli Kombëtar ka paraqitur një ankesë në emër të tij, sepse trajtimi diskriminues ka të bëjë me të si person fizik.**

Ankesa mund të hartohet:

- në një **formë** të lirë dhe/ose
- **duke plotësuar formularin e ankesës** i cili mund të gjendet në faqen zyrtare të internetit të Komisionerit.

Pavarësisht se si do të hartohet ankesa, është e rëndësishme të jetë:

- **e qartë,**
- **e kuptueshme,**
- **precize,**

- **koncize** dhe
- të përmbajë të dhëna **të sakta** dhe **të nevojshme**
  - a. për **aplikantin** ose personin e diskriminuar
  - b. për **atë që pretendohet se ka kryer diskriminimin**, dhe
  - c. për **aktin dhe/ose veprimin diskriminues**.

Ndërmjetësimi është një tjetër nga kompetencat që Mbrojtësi i Qytetarëve nuk e ka.

### **Ligji për Ndalimin e Diskriminimit**

("Gazeta Zyrtare e RS", nr. 22/2009)

#### **"Pajtimi**

Neni 38

Komisioneri **propozon** zbatimin e procedurës së **pajtim**it, në përputhje me ligjin që rregullon procedurën e ndërmjetësimi, **para ndërmarrjes së veprimeve të tjera procedurale.**"

Gjithashtu, për kryerjen efikase të tij është e nevojshme që të plotësohen disa kushte.

Komisioneri duhet të:

1. **propozojë pajtimin** nëse, pas shqyrtimit të ankesës, vlerëson se ekziston **mundësia e zbatimit të suksesshëm të tij**;
2. **t'i bëjë një propozim me shkrim për ndërmjetësim personit të diskriminuar, dhe personit që pretendohet se ka kryer diskriminimin,**
3. brenda **prej 15 ditësh ata janë të autorizuar të**
  - 3.1. deklarohen lidhur me propozimin**
  - 3.2. të caktojnë me marrëveshje një ose më shumë ndërmjetës; ose**
  - 3.3. të bien dakord që Komisioneri të emërojë ndërmjetësin.**

E HËNË E DIEL	E MARTË	E MËRKURË	E ENJTE	E PREMTE	E SHTUNË
<b>Dita e marrjes së propozimeve për kryerjen e ndërmjetësimit</b>					
		X Vendimi për propozimin e kryerjes së ndërmjetësimit			

Nëse **njëra ose të dyja palët**, brenda kohës së lejuar, **deklarojnë se nuk duan** të kryejnë ndërmjetësim **ose afati për deklarim ka kaluar, ndërmjetësimi nuk do të kryhet.**

Nëse **palët pranojnë ndërmjetësimin** brenda afatit të caktuar, **Komisioneri do të marrë vendim për caktimin e një ndërmjetësi.**

Komisioneri paraqet **një padi** në gjykatë **në bazë të një ankese të bërë,** dhe bashkëngjitjeve të dorëzuara me të, d.m.th. fakteve dhe provave që ato përmbajnë.

## **Rregullorja e Punës**

("Gazeta Zyrtare e RS", nr. 34/2011)

### **"Paraqitja e padisë dhe kallëzimit për kundërvajtje**

Neni 34

Kur në procedurën sipas **ankesën konstatohet** se ka pasur **diskriminim**, ..... Komisioneri ..... bën **padi** në gjykatën kompetente nëse çmon se, duke pasur parasysh rrethanat e çështjes, është e **përshtatshme për arritjen e mbrojtjes efektive nga diskriminimi, për përmirësimin e praktikës gjyqësore në çështjet gjyqësore për mbrojtjen nga diskriminimi, dhe për ndërgjegjësimin e publikut** etj..... "





Ky publikim është përgatitur me ndihmën financiare të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës. Qëndrimet e shprehura në këtë dokument nuk përfaqësojnë qëndrimin zyrtar të Bashkimit Evropian apo të Këshillit të Evropës.

SQI

Këshilli i Evropës është organizata kryesore për të drejtat e njeriut në kontinent. Ai përfshin 46 vende, duke përfshirë të gjitha shtetet anëtare të Bashkimit Evropian. Të gjitha shtetet anëtare të Këshillit të Evropës kanë nënshkruar Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, një marrëveshje që synon mbrojtjen e të drejtave të njeriut, demokracisë dhe shtetit të së drejtës. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut monitoron zbatimin e Konventës në shtetet anëtare.

[www.coe.int](http://www.coe.int)

Shtetet anëtare të Bashkimit Evropian kanë vendosur të bashkojnë njohuritë, burimet dhe fatet e tyre. Së bashku ato kanë ndërtuar një mjedis të qëndrueshëm, demokraci dhe zhvillim të qëndrueshëm duke ruajtur diversitetin kulturor, tolerancën dhe liritë individuale. Bashkimi Evropian është i përkushtuar të ndajë arritjet dhe vlerat e tij me vendet dhe popujt përtej kufijve të tij.

[www.europa.eu](http://www.europa.eu)

Financuar  
nga Bashkimi Evropian  
dhe Këshilli i Evropës



EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Zbatohet  
nga Këshilli i Evropës



Ministria e të Drejtave të Njeriut dhe të  
Pakicave dhe Dialogut Shoqëror